

## FTESË

### Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

#### Grupi i Punës III (Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit)

#### Sesioni 3: Modelet e zhvillimit socio-ekonomik për zonat rurale (Projekti pilot “Oazi Ekologjik i Butrintit”)

22 nëntor 2022, 11:00 – 13:00

Ferma Vlora Agriturizëm

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në bashkëpunim me Slovak Foreign Policy Association, me kontributin e Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH) dhe me mbështetjen financiare të SlovakAid ju fton në Sesionin 3 të Grupit të Punës III (Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit) me temë “Modelet e zhvillimit socio-ekonomik për zonat rurale” që po organizohet në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023.

Konventa fokusohet në 3 drejtime kryesore: 1) rritja e pjesëmarrjes së të gjithë segmenteve të shoqërisë shqiptare (përfshirë edhe nivelin lokal); 2) institucionalizimi i debatit publik në çështjet e BE-së bazuar në bashkëpunimin e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe ato të biznesit; dhe 3) forcimi i kapaciteteve në negociatat për integrimin në BE përmes transferimit të njohurive sllovaqe.

Në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me ministritë dhe agjencitë kyçe gjatë periudhës 2014-2021 si Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit etj. janë krijuar disa grupe pune për të adresuar kapitujt më sfidues të negociatave të acquis së BE-së. Deri më tani janë organizuar më shumë se 40 sesione të grupeve përkatëse të punës dhe 4 aktivitete plenare, në të cilat ekspertë vendas dhe më shumë se 20 ekspertë nga Sllovakia kanë ndarë përvojën dhe ekspertizën e tyre. Këto sesione kanë mbledhur më shumë se 500 përfaqësues nga institucionet shtetërore (ministritë, institucionet publike qendrore dhe lokale), nga sektori i shoqërisë civile, komuniteti i biznesit dhe shoqatat e punëtorëve, akademia dhe media, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga organizma të huaj dhe organizata ndërkombëtare në Shqipëri.

Gjatë Konventës 2021–2023 po organizohen 16 sesione për katër Grupe Pune, më konkretisht: **GP I** – Gjqësori dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23); **GP II** – Drejtësia, Liria, Siguria (Kapitulli 24); **GP III** – Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit (Kapitulli 11, 12 dhe 28); **GP V** – Çështjet e Tregtisë dhe Ekonomisë (Kapitulli 1, 2, 3, 4 dhe 20). Në këtë sesion, me kontributin e ekspertëve vendas dhe atij sllovak do të diskutohen nismat që kanë si synim zhvillimin e turizmit rural, agroturizmit, akuaturizmit dhe agropylltarisë, rregullat e prodhimit organik si dhe praktikmat më të mira në Sllovakia e BE.

Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në: [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org)

\*Gjatë aktivitetit do të ofrohet përkthim i njëkohshëm

## PROGRAMI

### **Konventa Kombëtare për Integrimin Europian**

**Grupi i Punës III (Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e**

**Konsumatorit)**

**Sesioni 3: Modelet e zhvillimit socio-ekonomik për  
zonat rurale (Projekti pilot “Oazi Ekologjik i Butrintit”)**

22 nëntor 2022, 11:00 – 13:00

Ferma Vlora Agriturizëm

**10:50– 11:00** Regjistrimi i pjesëmarrësve

**11:00 – 11:20** Hapja e aktivitetit

**Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv- Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)**

**Fjalët përshëndetëse**

**Arian Jaupllari, Zv. Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

**Ervis Moçka, Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë**

**Aulona Veizi, N/Kryetare e Bashkisë Vlorë**

**11:20 – 11:45** Modelet e zhvillimit socio-ekonomik për zonat rurale në Shqipëri

**Agim Rrapaj, Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar(KASH)**

*Modelet e zhvillimit rural dhe projekti “Oazi Ekologjik i Butrintit”*

*Hapat për zbatimin e nismës: (Bashkëpunimi dhe koordinimi; mekanizimi, inovacioni dhe*

*dixhitalizimi; financimi dhe mikrofinanca; përmirësimi i legjislacionit e përafrimi me atë të BE-së)*

*Rezultatet e pritshme*

**11:45 – 12:00** Diskutim i hapur me pjesëmarrësit

**12:00– 12:45** Eksperienca e Sllovakisë si vend anëtar i Bashkimit Europian për prodhimin organik dhe skemat mbështetëse

**Ján Baršováry, Drejtor i Departamentit të Bujqësisë dhe Shërbimeve/ Dhoma Sllovaqe e Bujqësisë dhe Ushqimit**

*Baza ligjore e BE-së dhe autoritetet përgjegjëse për rregullimin e prodhimit organik*

*Mënyra e aplikimit në skemat e mbështetjes për bujqësinë organike në Sllovaki*

*Modelet e zhvillimit rural në Sllovaki*

**12:45 – 13:00** Diskutim i hapur me pjesëmarrësit

**Mbyllja e takimit dhe koktejt**